

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Departamenti i Përfaqësimeve Gjyqësore me autorizim [REDAKTUAR] kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për shkak të pasurimit pabazë, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 15.03.2018, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës.
- II. DETYROHET** i padituri [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, që t'i paguaj paditëses shumën prej 880 € në emër të kthimit të mjeteve të fituara pa bazë ligjore apo pasurim të pa bazë me kamat ligjore 2.5% nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja me datën 23.04.2007 në gjykatë ka parashtruar padinë për pasurim të pa bazë kundër të paditurit, duke pretenduar se i padituri nga paditësja kishte marr pension për personat me aftësi të kufizuara në shumë prej 880 €, ku i njejtë në aplikacionin për pension nuk ka dhënë shënimet e sakta, me ç'rast nuk ka treguar se është pronar- posedon firmë private dhe për këtë arsye me datën 31.10.2005, paditësja i ka bërë ndërprerjen e pensionit. Paditësja pas monitorimit dhe rishqyrtimit në terren si dhe në ATK, ka konstatuar se pagesa është bërë në kundërshtim me ligjin mbi Pensionet për personat me aftësi të kufizuara, ku i njejtë thot se personat që janë të punësuar apo në çfarëdo mënyre të vetë punësuar nuk ka të drejtë të jenë përfitues të kësaj skeme dhe obligohen që të kthejnë shumat e përfidutara në mënyr të paligjshme, paditësja nga i padituri ka kërkuar kthimin e mjeteve por i njejtë deri më tani këtë gjë nuk e ka bërë..

Paditësja në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideroj se gjykata ka prova të mjaftueshme me të cilën vërtetohet se i padituri ka tërhequr vlerën prej 880 € në kundërshtim me ligjin mbi pensionin me aftësi të kufizuara me qenëse i njejtë ka poseduar biznes, prandaj gjykatës i propozojë që të aprovojë padinë dhe kërkesën e saj me të cilën vërtetohet nga pasqyra- lista e qendrës informative, ashtu që të detyrojë të paditurinë që shumë si në padi të i`a kthejë paditëses në llogarinë bankare 10004320700032622.

I padituri në seancat e mbajtura si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, pasi që unë në momentin e marrjes së pensionit invalidor unë i kam plotësuar kushtet ligjor për të qenë përfitues i saj, sa i përketë firmës e njejtë është regjistruar në vitin 1994, ndërsa që nga vitit 1999 e këndeje unë nuk punoj pasi që nuk kam qenë mirë me shëndet dhe kam pasur shumë operacione, që nga viti 2000 nuk kam punuar me këtë firmë dhe nuk kam fituar asgjë nga frima shpt '████', andaj i ka propozuar gjykatës që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. .

Gjykata, me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: Listën nga Qendra informative e llogarisë rrjedhëse nr ████████ në emër të ████████ Format për shemen e pagesave të kryera në emër të ████████ Qarkullimin bankar NLB Banka Prishtinë e datës 22.10.2015, Raportin mjekësor nga Qendra Mjekësore në Ferizaj në emër të ████████ i datës 18.09.2006, Raportin Specialistik nga Ordinanca "Hipokrati" i datës 16.06.2005, Fletë lëshimi nga QKUK, Prishtinë me të cilin vërtetohet se ████████ ka qëndruar i shtrirë në spital nga data 03.02.2004 deri më 18.02.2004 dhe Raportin nga shërbimi ambulantor kardiologjik "Zemra".

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nga administrimi dhe shqyrtimi i provave, ka konstatuar se ekziston fakti se paditësi ka të regjistruar biznes në emër të tij, me numër biznesi 80045735 me enër SH.P.T '████', gjë që është në kundërshtim me dispozitat ligjore për përfitimin e këtij pensioni, andaj gjykata konform nenit 3.4 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara lidhur me nenin 194 të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me lartësin e aprovuar të kërkesëpadisë për pasurim të pa bazë, paditëses ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej ditës së plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së, që i padituri paditëses ti kompensoj shpenzimet e kësaj procedure.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.133/16, me datë 15.03.2018



Gjyqtari,

Misin Frangu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

Më 24 05 20 18
Dana

